

Akademik Jashar REXHEPAGIQ

VLERA SHKENCORE E TË MËSUARIT ISLAM DHE DOMETHËNIA E TOLERANCËS NDËRFETARE

Ajeti 256 i kreut të dytë të Kuranit (La ikrahe fi-d-dini) thotë: “Në fe nuk ka dhunë”. Disa hulumtues të huaj këtë ajet të cituar e konsiderojnë si proverbin më të lartë të këtij libri të shenjtë. Në fjalinë e përmendur, është theksuar parimi për lirinë në të gjitha fushat e jetës shpirtërore. Po ashtu, në hadith të Muhamedit (a.s.) tekstualisht thuhet: “Musliman i vërtetë është vetëm ai që nuk i shqetëson njerëzit e tjerë me gjuhën e vet dhe me veprimet e veta”. Fjala është për mësimin islam, që është, pa dyshim, human dhe dallohet sipas universalitetit, mendimeve të pasura dhe njohurive të gjithanshme.

Siç dihet, në territorin e ish-Jugosllavisë besimtarët islamë i takonin nacionaliteteve të ndryshme, numri i të cilëve e tejkalonte shifrën katër milion. Në Kosovë, përveç shqiptarëve, të kësaj feje janë turqit, boshnjakët, ashkalitë e të tjerë, pra, besimtarë të përkatësive të ndryshme etnike, të cilët e japin kontributin e tyre për ndërtimin e një Kosove më të sigurt. Këtu, edhe përmendoret më të rëndësishme mesjetare mbijetuan pesëqind vjet nën qeverinë turke. Manastirët e fuqishëm të Frushkagorës, afër Beogradit, pas 300 vjetësh të ruajtjes në periudhën osmane, nuk mbijetuan as tre vjet. Ata u dogjën gjatë Luftës II Botërore. Edhe Bosnja e Hercegovina është një konglomerat i besimeve - islame, katolike, ortodokse e hebraike dhe i popujve të ndryshëm. Këtu gjithnjë ngjanin kthesat historike dhe ishte shënuar vija ndarëse ndërmjet Lindjes dhe Perëndimit. Në këtë vend, gjer në luftën gjakatare, në vitet 1992-1995, kur u shkatërruan rreth një mijë xhami, kanë ekzistuar me shekuj, shpeshherë njëra afër tjetrës, xhamitë, katedralet, kishat ortodokse dhe sinagogat. Sot në Bosnjë bëhet përpjekje që të pajtohen popujt e besimet dhe të krijohet shoqëria e tolerancës fetare e nacionale, në frymën e ajetit kuranor, se “në fe nuk ka dhunë”.

Nuk duhet harruar se çdo popull, si dhe besimet e ndryshme në botën pluraliste, kanë kulturat e tyre të veçanta, kështu që edhe toleranca dhe dialogu ndërfaqor, njëkohësisht, kanë edhe karakter ndërkulturor.

Islami parapëlqen vlerat etike dhe universale, të cilat nuk i ndajnë njerëzit, por, përkundrazi, i bashkojnë.

Shumica e popujve të Ballkanit, ndër ta edhe shqiptarë, e kanë pranuar Islamin, para së gjithash nga shumë pëlqyeshmëri të tij e disa edhe për shkak të ngjashmërisë së besimit të tyre me fenë islame (p.sh. Pataret në Bosnjë), kështu që doktrinën islame e pranuan pa detyrim, në përgjithësi. Prandaj, edhe idetë: islamizëm, islamizim, islamizoj, ndoshta do të duhej të përdreshin më rrallë. Nga aspekti shkencor e historik, do të ishte më drejt që, në vend të tyre, të thuhet: përhapja ose pranimi i Islamit. Edhe tek autorë shqiptarë përdoret së tepërmi termi "islamizimi", si p.sh. dr. Don Shan Zefi, vepra e të cilit është me titull "*Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve*" (Prizren, 2000). Po në këtë libër, gati në tërë përmbajtjen po theksohen pothuajse tërësisht anët negative të ndikimit të fesë dhe të kulturës islame.¹ Megjithatë, nocioni islamizim, që përdoret shumë sidomos në botën perëndimore, sjell ndërmend terma të ndryshme që janë tejet negative, kurse në historinë njerëzore të njohura si teori dhe veprime më regresive, siç janë: fashizmi, militarizmi, shovinizmi, klerikalizmi, unitarizmi, monizmi etj. Kjo nuk do të thotë asesi që, për tolerancën fetare në këto treva të Ballkanit, të shkruhet në mënyrë jokritike, p.sh. në periudhën e shtetit teokratik turk harrohet statusi shtetëror i besimit islam. Në Mbretërinë Jugosllave, po ashtu, ishte proklamuar barazia formale e bashkësive religjioze, por, në të vërtetë, dominonte fryma ortodokse, sidomos në sistemin arsimor dhe në jetën publike. Edhe sot, në kushtet e shtrirjes shkencore-teknologjike dhe informatike të civilizimit më të zhvilluar perëndimor, dallohet besimi kristian, kurse në disa shtete, p.sh. në Francë, edhe tani nuk lejohet ngritja e xhamive.

Njohuritë e mësimi islam dhe kontributi i tyre për civilizimin dhe kulturën e entitetit musliman, bashkë me objekte dhe krijime të shumta edhe të jomuslimanëve, dëshmojnë edhe më tepër vlerën e tyre shkencore dhe gjithëkulturore.

Termi Islam ka prejardhje arabe dhe do të thotë “përkushtim (Zotit)”. Sipas qëndrimit të doktrinës islame, religjioziteti i njeriut është dhënë në mënyrë të natyrshme e njëkohësisht është pjesë përbërëse reale dhe qenësore e personalitetit.

I pazëvendësueshëm dhe i pamatshëm është roli i besimit, respektivisht i bashkësive fetare në zhvillimin e shoqërisë civile dhe bashkësisë multikonfesionale, multietnike dhe multikulturore.

Dimensionimi shkencor i Islamit dhe domethënia e tolerancës fetare duhen shqyrtuar, duke u mbështetur në burime të ndryshme islame e, në veçanti në *Kuranin*, i cili shërbente me shekuj si libër leximi dhe kishte rolin kryesor në formimin e vetëdijes kulturore. Kjo vepër u botua në disa gjuhë. Në gjuhën shqipe, gjer më tani, kemi disa përkthime kuranore, që, po ashtu, dëshmojnë vlerën e tij të lartë. *Kurani e ngriti shkencën në nivelin më të lartë* dhe këtë e pohojnë me dhjetëra ajete, në të cilat theksohet roli i diturisë, i njohurive shkencore dhe nga individët kërkohet të mësojnë, mendojnë, krahasojnë, vërejnë, studiojnë, shqyrtojnë dhe të zbulojnë të vërtetën. Këshillat e shpeshta të All-llahut xh.sh. ishin: gjurmo, mëso, studio, njihe veten e botën dhe përparo! Vetë shpallja e Kuranit ka filluar me urdhrin: Ikra (Lexo !). Ky libër i shenjtë duhet studiuar vazhdimisht dhe në mënyrë sa më serioze.

Përveç disiplinave teologjike, siç janë *Kiraet* (lexim i drejtë i Kuranit), *Tefsiri* (komentimi i Kuranit), *Hadithi* (të folurit dhe porositi e Muhamedit), *Fikth* (për të drejtën e sheriatit), *Ahlak* (për moralin dhe sjelljen), si dhe disa disiplina që i tejkalojnë caqet e besimit, sikurse është *kultura dhe civilizimi islam*, mësimi islam çoi përpara edhe mendimin filozofik, sidomos tek mendimtarë arabë dhe persianë, prandaj flasim për *filozofinë e islamit*, sidomos për mistikën islame (*Tesavuf*), gjithashtu për *etikën e islamit*, për *kulturën islame*, për *arsimin islam*, për *sistemin ekonomik të islamit*, si dhe për kontributin e Islamit në zhvillimin e shkencave të tjera veç e veç.

Pothuajse nuk ka shkencë me të cilën dijetarët dhe mendimtarët islamë nuk janë marrë. Ata, njëkohësisht, përparuan *disiplina të shumta shkencore*, kështu që gjatë disa

shekujve (që nga shekulli VII), në një hapësirë të gjerë, nga Oqeani Atlantik, lumi Ind e deri në Kinë lulëzoi sistemi shkollor, duke përfshirë edhe universitetet e para mesjetare arabe, bibliotekat, qendrat shkencore, kulturore etj. Për shembull, alnafabetizmi ndërmjet dy luftërave botërore në shumë vende islame ishte mbi 50%, në Pakistan 75%, në Algjeri 80%, në Nigeri 90% etj., por edhe në Ballkan, sidomos në Kosovë dhe në vende të tjera, ku shumicën e përbënin banorët e fesë islame, ndërsa në Spanjën islame të shek. X e XI, sipas Dreperit, nuk kishte analfabetë. Sot në Perëndim veçanërisht në literaturë, në sistemet arsimore etj., përveç propagandës dhe emocioneve antiislame, kundër botës moderne islame (umma), muslimanët janë objekt i urrejtjes e i degradimit dhe zakonisht etiketohen si agresivë, destruktivë, fanatikë, të prapambetur etj. Vetë sistemi laik i arsimit në botën islame ishte nën ndikimin e sekularizmit perëndimor, edhe kur përjetonte krizën më të thellë, ndërsa gazetatat, librat dhe revistat, radioja, televizioni etj. sulmonin çdo gjë që i takonte kulturës islame, madje edhe tekstin kuranor, i cili është pa dyshim më racional.

Po ashtu, në botën islame Perëndimi konsiderohet si e keqja më e madhe. *Madje, ndjenjat antiislame në Perëndim dhe antiamerikane në botën islame janë të tepërta dhe të dëmshme*, kështu që shkenca, institucionet fetare dhe njerëzit e urtë ftohen të përpiqen që këto njëanshmëri t'i kapërcejnë. Vetë ajeti 177 i kreut 2 (Surja "El Bekare") fillon me këto fjalë: "Nuk është tërë e mira të ktheni fytyrat tuaja nga lindja ose nga perëndimi". Do të ishte e dobishme që këtë ta kemi parasysh në përmbajtjen e studimit islam, por edhe në studimin krahasues të besimeve dhe civilizimeve të tjera. Të mos harrojmë se vetë Islami e përbuz ndarjen e njerëzve në fetarë e laikë. I Dërguari tha se "është detyrim i çdo muslimani dhe muslimaneje që të kërkojnë dituri". Nga kjo, del qëndrimi për ndërvartësi kulturo-civilizuese të të gjitha pjesëve të Ballkanit dhe të botës, pra, edhe të kulturave të ndryshme, të besimeve, kombeve, ideologjive etj., dhe lind nevoja e domosdoshme që të largohemi nga çdo izolim dhe ekskluzivitet.

Prej shumë filozofëve, shkrimtarëve dhe shkencëtarëve do të përmend vetëm dy personalitete: *Al-Birunin* (973-1048),

shkrimtar persian dhe shkencëtar i madh, një nga gjenitë më të mëdhenj të botës mesjetare, i cili, përveç të tjerash, reformoi kalendarin, përcaktoi gjerësi dhe gjatësi gjeografike etj. dhe është i njohur për numrin më të madh të studimeve historike dhe matematikore.

Autori tjetër është *Omer Kajami* (1050-1126), i cili nuk qe vetëm poet i Rubairave (që në gjuhën shqipe i ka përkthyer shkrimtari Fan S. Noli (1882-1965) dhe iranologu Hafiz Ali Korça (1874-1957), ndërsa në gjuhën serbokroate dr. Safvetbeg Bashagiq dhe dr. Fehim Bajraktareviq), por edhe shkencëtarë të tjerë, në radhë të parë matematikanë e astronomë. Titulli *hakim* që e fitoi, u është dhënë shkencëtarëve që ishin të orientuar në të gjitha njohuritë shkencore të kohës së vet.

Nuk duhet harruar qëndrimi human dhe racional ndaj besimeve, sidomos ndaj mendimtarëve islamë të kohës së re. Gëte (1749-1832) p.sh. në moshën 23-vjeçare hartoi “një himn madhështor” kushtuar Muhamedit (a.s.) Përmbledhjen e tij prej 250 vjershave, të shkruara në frymën e Islamit, e titulloi *Divani Perëndimor-Lindor*.

Në disa ajete çmohet posaçërisht mendimi shkencor dhe arsimit. Në njërin thuhet tekstualisht se “ai që kërkon dituri, nuk vdes”. Imam Aliu, për shembull, në “Shtegu i të shqiptuarit” (kroat. *Staza rjeëitost*, Zagreb, 1994) në fq. 244 pohon se “dija është më e mirë se pasuria. Dituria të mbron Ty, ndërsa Ti je i detyruar ta ruash pasurinë. Pasuria zvogëlohet me shpenzim, kurse dija shumohet me ndarje”. Shpeshherë citohet fjala e tij (imam Aliut): “All-llahu le të mos më bekojë në atë ditë, kur nuk mësoj diçka të re!”.

Në ajetin 66 të kreut 3 (Surja “Ali Imran”) thuhet: “Ja, ju jeni ata që polemizuat edhe për atë që e dinit (për Isain), e përse polemizoni për atë që s’keni kurrfarë dije (për Ibrahimin). Allahu di të vërtetën, kurse ju nuk dini”.

Edhe ajeti 71, në të njëjtin kre, ka një vlerë arsimore-kulturore, teksa flitet për librin dhe për nevojën e njohjes së të vërtetës. Teksti thotë: “O ithtarë të librit, meqenëse ju e dini të vërtetën, përse e ngatërroni me gënjeshtërën dhe e fshihni realitetin?”.

Vlerë pedagogjike ka sidomos ajeti 122 i kreut 8 (Surja

“El Enfale”), që ka këtë përmbajtje:

“Nuk është e nevojshme të dalin në luftë të gjithë besimtarët. E përse nga çdo grumbull i tyre të mos shkojë një grup për t’u aftësuar në diturinë fetare, për ta mësuar popullin e vet kur të kthehet tek ata, në mënyrë që ata ta kuptojnë të vërtetën”.

Se sa shumë çmohet dituria, e dëshmojnë edhe këto fjalë të urta të Kuranit, në ajetin 11 të kreut 58 (Surja “El Muxhadele”):

“... Allahu ... i lartëson në shkallë të lartë ata që janë pajisur me dituri”.

Në kreun 96 (Surja “El Alak”) në aspektin arsimor dallohen këto ajete:

“3. Lexo! Se Zoti yt është më bujari!

4. Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë.

5. Ia mësoi njeriut atë që nuk e dinte.”

Këto ajete dëshmojnë se muslimanët, gjatë shekujve të parë kanë mbrojtur dhe kultivuar mendimin shkencor e arsimin dhe, në këto fusha, ata kanë qenë shembull i tërë njerëzimit.

Nga shumë ajete të tjera, në kaptullin 103 (Surja “El Asr”) tre ajetet e para kanë një vlerë më të gjerë. Ato janë këshilla edukativo-etike dhe udhëzime të rëndësishme për çdo njeri. Ja këto fjali:

“1. Pasha kohën!

2. Nuk ka dyshim se njeriu është në një humbje të sigurt.

3. Me përjashtim të atyre që besuan, që bënë vepra të mira, që porositën njëri-tjetrin t’i përmbahen së vërtetës dhe që këshilluan njëri-tjetrin të jenë të durueshem. “

Dituria, sipas Kuranit, s’ka fund, e këtë e dëshmon ajeti 76 i kreut 112 (Surja “Jusuf”): “Nga shumë të dijshtëm-ka edhe më të dijshtëm”.

Pa dyshim se Kurani dhe burime të tjera islame, me shumë ide dhe qëndrime të sakta e progresive, as tashti dhe as në të ardhmen nuk mund ta humbin rëndësinë, sidomos rolin shkencor dhe pedagogjik të tyre. Prandaj, do të ishte e nevojshme dhe jashtëzakonisht e dobishme që të organizohen gjurmime sa më të gjithanshme të Kuranit, në mënyrë që të njihet më mirë ky trashëgim shumëshekullor islam.

Sot, në disa universitete të vjetra, siç është Al-Azhar në Kajro, që u themelua më 972, po ashtu universiteti më i vjetër Karauin, në qytetin Fes (në Marok), i themeluar më 859 dhe në universitetet e tjera, ligjërohet ndaras "Pedagogjia islame". Mjerisht, deri më tani nuk është përkthyer asnjë libër i këtij lloji. Edhe në Islam, edhe në fenë ortodokse, por edhe në atë katolike, mungon studimi në aspektin pedagogjik, si dhe shqyrtimi i çështjeve pedagogjike, kur merren parasysh edhe normat teologjike. Merren parasysh kështu p.sh. fjalët: besimi, faltorja, besimtari etj., deri në ditët tona nuk përdoren.

Mësimi islam i vlerëson lart *kategoritë* dhe *edukatën etike*: mirësinë (me'ruf), humanizmin, drejtësinë, durimin dhe ndihmën ndaj të varfërve. Islami është kundër çfarëdo pabarazie ndërmjet njerëzve, e këtë e vërteton parimi i proklamuar i Muhamedit (a.s.): "O njerëz, Zoti Juaj është një. Mbani mend se arabi nuk ka kurrfarë përparësie ndaj joarabit, dhe as joarabi ndaj arabit. E vetmja përparësi gjendet në veprat e mira (*takva*)."² Në Kuran kritikohen ashpër veset, padrejtësitë, prapësitë e këqija, dhuna, intolerancat, urrejtjet, epshet negative etj.

Se sa të përsosura janë thëniet e Pejgamberit (a.s.), sidomos ato për rolin e diturisë dhe të arsimit të të gjithëve edhe në vendet më të largëta, për ilustrim po i citojmë këto hadithe:

- Kërkojeni diturinë prej djepit deri në varr.
- Kërkimi i diturisë është detyrë parësore për çdo musliman dhe muslimane.
- Kërkojeni diturinë, qoftë edhe në Kinë!
- Ai që kërkon diturinë, nuk vdes.³

Këtu do të shtoja edhe hadithin: "Kujt ndjek rrugën për të fituar diturinë, Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në Xhenet."⁴

Fjala më e bukur e Muhamedit (a.s.) për rolin e dijes është kjo: "Bëhu dijetar, bëhu dijetar, bëhu dijetar; në mos dijetar, të bëheni nxënësit e dijes; në mos nxënësit e dijes, në mos nxënësit e saj, të bëheni admiruesit e saj, adhuresit dhe simpatizuesit i saj".⁵

Burimet islame, posaçërisht Kurani, me përmbajtjen e vet, faktikisht prekin këto fusha dhe disiplina pedagogjike: *et-terbijetu' r-ruhijje* (edukimi i shpirtit), *et-terbijetu' l-ahlakije*

(edukimi i moralit), *et-terbijetu' l-aklijje* (edukata intelektuale), *et-terbijetu' l-d•ismijje* (edukata fizike), *et-terbijetu' l-d•emalijje* (edukata estetike), *et-terbijetu' l-id•timaijje* (edukimi i personalitetit shoqëror), *et-terbijetu' s-sijasijje* (edukimi i personalitetit politik).

Mund të përfundohet se Kurani është jo vetëm burim i rëndësishëm i arsimit dhe i kulturës islame, por, njëkohësisht, edhe vepër nga e cila nxirrnin idetë filozofët, linguistët, sociologët, teologët, poetët, juristët, historianët, psikologët, pedagogët etj., por në kohën më të re, edhe gjurmuesit e disa shkencave natyrore. Një kirurg francez (Maurice Bocaille), në veprën e vet "Bibla, Kurani dhe shkenca", ka konstatuar saktësinë e pabesueshme të hollësive të caktuara në Kuran. Ndërsa në Bibël zbuloi gabime të rënda, në Kuran nuk ishte në gjendje të gjente asnjë gabim. Ai parashtrroi edhe pyetjen se si në shekullin VII autori i Kuranit ka mundur të shënojë disa fakte, të cilat sot i zbulon shkenca moderne.⁶ Sipas shkencëtarit kroat (Eduard Kale) dhe veprës së tij "Historia e civilizimit" (kroatisht, Zagreb 1988), Islami është "besim dhe bashkësi e kulturës laike, por domethënë edhe uniteti i tyre".⁷ Sipas tij, Kurani është "vepër e Muhamedit, më e plotë prej librave të shenjtë të të gjitha besimeve të tjera; aty gjen trajtime për çdo çështje të jetës, ja se pse (Kurani) u bë themeli i tërë kulturës islame".⁸

Nga përmbajtja e besimit islam dhe e besimeve të tjera, si dhe nga realiteti në shumë vende ballkanike, i cili, sidomos në vitet "90" të shekullit XX qe jashtëzakonisht i përzier dhe i mbushur me përçarje, urrejtje dhe veprime johumane, del kërkesa më e rëndësishme – *toleranca ndërjetare*, e cila do të thotë durimi, marrëveshja, lejimi i mendimeve të huaja, edhe kur me ato pajtohem vetëm pjesërisht. *Toleranca në esencë* është tendencë progresive, qëndrim human dhe pozitiv ndaj besimit, kulturës dhe popujve të tjerë. E ngjashme me tolerancën etnike, ndërkulturore, ndërnjerëzore etj., toleranca ndërjetare ka për qëllim që të ekzistojë durimi dhe të kuptuarit fetar, bazuar në drejtësinë, vëllazërinë, besimin dhe në dashurinë ndaj Zotit. Jam thellësisht i bindur se ajo mund të kontribuojë shumë në *shmangien, ose, së paku, në zvogëlimin e antagonizmave dhe*

moskuptimeve ndërmjet muslimanëve dhe jomuslimanëve dhe ndërmjet besimeve të ndryshme. Kjo mund të arrihet në bazë të kontakteve ndërjetare, dialogjeve dhe qëndrimit tolerant ndaj çdo feje; pra, në frymën e pluralizmit religjioz dhe duke u bazuar në shembujt pozitivë të së kaluarën së popujve të ndryshëm, në veçanti të shqiptarëve.

Si përfundim, mund të themi:

Së pari, nuk do të ketë paqë ndërmjet kombeve-pa paqe ndërmjet besimeve, dhe as paqë ndërmjet besimeve-pa tolerancën aktive dhe dialogun ndërmjet besimeve, kulturave e civilizimeve. Nëse do të fitojë toleranca e mirë fetare, dialogu i lirë dhe i hapët, do të fitojë Njeriu, ose, siç thoshte Hafëzi i mençur (i shekullit XIV): “Nga fjalët e dashurisë nuk kam parë asgjë më të ëmbël”.

Përfundimi i dytë është përvoja pozitive për tolerancën ndërmjet shqiptarëve katolikë, muslimanë e ortodoksë, te të cilët kishte më së shumti mirëkuptim dhe bashkëpunim, sepse ata janë një popull, një komb. Nuk duhen harruar disa dispozita në Kanunin e Lekë Dukagjinit, po ashtu edhe idetë progresive të Vaso Pashës, Naimit dhe rilindësve të tjerë, si dhe faktin se feja islame e çmon lart paqën dhe bashkëpunimin.

Përveçse në Shqipëri, për këtë ka shembuj edhe në Kosovë, për familje të përziera nga besimi, siç është ndoshta shembulli më tipik ai i dy vëllezërve në fshatin Zheger, nga të cilët njëri është shkolluar për prift e tjetri për hoxhë.⁹

¹ Don Shan Zefi, “Islamizimi i shqiptarëve gjatë shekujve”, Prizren 2000, fq. 122-123.

² Husein Djozo, “Fetve”, Novi Pazar, 1996, fq. 129.

³ “Feja, kultura dhe tradita Islame ndër shqiptarët”, Prishtinë, 1995, në fq. 108.

⁴ “Tako je govorio Muhamed Resulullah”, Novi Pazar, 1998, fq. 161.

⁵ Faik Luli - Islam Dizdari, “Një jetë në shërbim të fesë”, Tiranë, 1996, fq. 229.

⁶ Esad Bajic, “Kuranski izazov znanosti, Konjic”, 2003, fq. 128-129.

⁷ Po aty, fq. 150.

⁸ Po aty, fq. 155-156.

⁹ Mark Krasniqi, “Lugu i Baranit”, Prishtinë, 1984.